



Kuvendi i Komunës Klinë

01Nr. 06-32601 /2025

Datë: 25.09 /2025

Duke u mbështetur në nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja d), nenin 30, si dhe në nenin 40, paragrafi 40.2, shkronjat j) dhe l) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, në nenin 10, pika 4) dhe nenin 40, pika 11 të Statutit të Komunës së Klinës, i miratuar në mars 2010, në nenet 7, 8 dhe 18 të Ligjit Nr. 04/L-010, si dhe në Rregulloren e MAPL-së për procedurën e bashkëpunimit ndërkombëtar Nr. 0203-1334, me propozimin e Kryetarit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Klinës, në seancën e VIII-të të rregullt për vitin 2025, të mbajtur më datë 19.09.2025, mori këtë:

V E N D I M

Për miratimin e marrëveshjes ndërkomunale-ndërkombëtare me Komunën Quinto Di Treviso në Itali

1. Miratohet Marrëveshja e Bashkëpunimit-Binjakëzimit ndërmjet Komunës së Klinës, Republika e Kosovës, dhe Komunës Quinto Di Treviso, Republika e Italisë, e cila ka për qëllim zhvillimin e bashkëpunimit në fushën e shëndetësisë, arsimit, kulturës, rinisë dhe sportit, si dhe në fushën e zhvillimit ekonomik dhe turizmit, mbi bazën e reciprocitetit dhe përfitimit të ndërsjellë.
2. Qëllimi i marrëveshjes është forcimi i miqësisë, mirëkuptimit dhe bashkëpunimit ndërmjet dy komunave në kuadër të një partneriteti evropian, në frymën e paqes, tolerancës, demokracisë dhe zhvillimit të përbashkët.
3. Marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Kryetarit të Komunës së Klinës dhe Kryetarit të Komunës Quinto Di Treviso është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
4. Zbatimin e këtij vendimi dhe të marrëveshjes e siguron Kryetari i Komunës së Klinës, përmes organeve përgjegjëse për implementimin e saj, sipas fushave përkatëse të bashkëpunimit.
5. Vendimi hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Komunës, bazuar në Ligjin Nr. 08/L-284, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- MAPL;
- Kryetari i Komunes;
- Komuna Quinto Di Treviso, Republika e Italisë;
- Zyra për Informim;
- Arkivi.

